

20040661213

L I G J I PËR MUZETË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e punës së muzeve, kryerja e veprimtarisë së muzeve, themelimi, llojet e muzeve, organizimi, koordinimi, titujt profesionalë, mbikëqyrja dhe çështjet tjera që janë me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë së muzeve në Republikën e Maqedonisë.

Materiali muzeor dhe lënda muzeore

Neni 2

(1) Material muzeor janë lëndët arkeologjike, etnologjike, historike, artistike dhe teknike, si edhe ekzemplarët paleontologjikë, gjeologjikë, zoologjikë dhe botanikë që janë furnizuar nga ana e muzeut për shkak të hulumtimit, rregullimit, përpunimit profesional dhe shkencor, studimit dhe prezentimit, deri në evidentimin e tyre në librin e inventarit të muzeut.

(2) Lëndë muzeore është materiali muzeor nga paragrafi (1) i këtij neni i cili, përshkak të vlerave, vetive, përmbajtjeve ose funksioneve të veta, ka rëndësi kulturore, shkencore, historike dhe natyrore dhe është evidentuar në librin e inventarit të muzeut, për çka shfrytëzimi dhe rëndësia e tij gjenden nën regjim juridik në pajtim me ligjin.

(3) Materiali muzeor dhe lëndët muzeore përbëjnë fondin e muzeut.

II. LLOJET E MUZEVE, THEMELIMI DHE NDËRPRERJA E PUNËS

Muzeu

Neni 3

(1) Muzeu është institucion joprofitabil nga lëmi i kulturës.

(2) Muzetë kryejnë hulumtimin, grumbullimin, rregullimin, përpunimin dhe studimin profesional dhe shkencor, mbrojtjen, ruajtjen, shpalljen dhe prezentimin e lëndëve muzeore (në tekstin e mëtejshëm: veprimtari muzeore).

(3) Muzeu është institucion i hapur për opinionin i cili ka edhe rol edukativ që të tërheqë publikun më të gjerë nga të gjitha shtresat e shoqërisë dhe të zhvillojë komunikim interaktiv me vizitorët, për popullarizimin e trashëgimisë kulturore të tundshme.

Veprimtari muzeore

Neni 4

(1) Veprimtaria muzeore është veprimtari me interes publik.

(2) Veprimtari muzeore sipas dispozitave të këtij ligji, kryejnë muzetë dhe koleksionet e pavarura muzeore, si dhe galeritë dhe koleksionet e pavarura të galerive, nëse janë regjistruar për kryerjen e veprimtarisë muzeore (në tekstin e mëtejshëm: muzetë).

(3) Veprimtari muzeore mund të kryejnë edhe persona tjerë jidike nëse janë regjistruar për kryerjen e veprimtarisë muzeore dhe të njëjtën e kryejnë në pjesë të organizuar në mënyrë të veçantë, nën kushtet e përcaktuata me këtë ligj dhe ligj tjetër, si muze në përbërje.

Zbatimi i dispozitave tjera

Neni 5

(1) Për themelimin, punën dhe ndërprerjen e muzeve, udhëheqjen, vendosjen, financimin dhe mbikëqyrjen administrative, zbatohen dispozitat nga Ligji për kulturë, nëse me këtë ligj dhe me ligj tjetër nuk është përcaktuar më ndryshe.

(2) Mbrojtja e lëndëve muzeore bëhet në pajtim me këtë ligj, Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe dispozitat për mbrojtjen e natyrës.

Llojet e muzeve

Neni 6

(1) Muzetë, sipas themeluesit mund të jenë publikë (nacionalë dhe lokalë) dhe privatë.

(2) Muze nacional mund të themelojë Qeveria e Republikës së Maqedonisë, kurse muze lokal mund të themelojnë komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit.

(2) Muze privat mund të themelojë personi juridik dhe fizik i vendit dhe i huaj, në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

(4) Muzetë në përbërjen e vet mund të kenë edhe njësi organizative të cilat gjendet jashtë selisë së muzeut.

(5) Muzetë sipas lëndës të punës së vet janë të përgjithshëm dhe të specializuar. Sipas llojit të lëndëve muzeore, muzetë mund të jenë arkeologjikë, historikë, etnologjikë, artistikë, arkitektonikë, teknikë, shkencorë-natyrorë, si dhe zejesh, teatralë, filmikë, postalë, ushtarakë, hekurudhorë, kishtarë, etj.

(6) Lloji i muzeut përcaktohet me aktin për themelimin e tij.

Kushte të veçanta për fillimin me punë të muzeut

Neni 7

(1) Muzeu në pajtim me ligjin mund të fillojë me punë nëse i plotëson kushtet e veçanta vijuese:

1) të jenë siguruar mjete themelore për fillimin me punë;

2) të jenë siguruar mjete financiare për kryerjen e qëndrueshme të veprimtarisë;

3) të ekzistojë elaborat për themelimin e muzeut;

4) të jenë siguruar lokalet dhe pajisja përkatëse për ruajtjen dhe prezentimin e fondit të muzeut;

5) të jetë siguruar materiali muzeor me dokumentacionin i cili mund të shërbejë si fond themelor muzeor dhe

6) të ketë kuadër profesional përkatës.

(2) Për plotësimin e kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni, ministri, i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i kulturës (në tekstin e mëtejme: ministri), merr vendim pas marrjes së mendimit paraprak nga muzeu kompetent amë.

(3) Kundër vendimt nga paragrafi (2) i këtij neni mund t'i ushtrohet ankesë Komisionit të Qeverisë. Ankesa nuk e shtynë vendimin.

(4) Standardet për përcaktimin e llojeve të muzeve, për punën e tyre, për vendosjen dhe për ruajtjen e objekteve dhe të dokumentacionit muzeor, i përshkruan ministri.

Vlerësimi i punës së muzeut

Neni 8

Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i kulturës) në tekstin e mëtejme Ministria) në çdo pesë vjet nga dita e marrjes së vendimit për plotësimin e kushteve për punën e muzeut, detyrimisht bën vlerësimin e plotësimit të kushteve të punës nga neni 7 i këtij ligji.

Ndërprerja me punë e muzeut

Neni 9

(1) Muzeu mund të ndërpresë me punë nëse nuk i plotëson kushtet e veçanta për fillimin me punë.

(2) Themeluesi vendos për ndërprerjen e muzeut, nëse muzeu nuk e kryen veprimtarinë ose ndërpret interesin për realizimin e të cilit është themeluar muzeu.

(3) Në rast të ndërprerjes me punë të muzeut publik, vendimi për ndërprerjen e muzeut doemos duhet të përmbajë edhe dispozita për mbrojtjen dhe vendosjene lëndëve dhe të dokumentacionit muzeor, kurse në muze tjetër përkatës.

(4) Nëse Ministria gjatë vlerësimit për plotësimin e kushteve për punë nga neni 8 i këtij ligji konstaton se muzeu nuk i plotëson kushtet nga neni 7 i këtij ligji, ministri pas mendimit të marrë paraprakisht nga muzeu kompetent amë, merr vendim për ndërprerjen me punë të muzeut.

(5) Para marrjes së vendimit nga paragrafi (4) i këtij neni, ministri me vendim përcaton afat në të cilin muzeu duhet t'i plotësojë kushtet nga neni 7 i këtij ligji.

(6) Kundër vendimt nga paragrafi (4) dhe (5) i këtij neni mund t'i ushtrohet ankesë Komisionit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Ankesa nuk e shtynë vendimin.

III. THEMELIMI, UDHËHEQJA, ADMINISTRIMI DHE FINANCIMI I MUZEVE PRIVATE DHE LOKALE

Themelimi i muzeve lokalë

Neni 10

(1) Këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, merr vendim për themelimin e muzeut lokal, sipas kushteve dhe standardeve të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Muzeu lokal ka statut, me të cilin rregullohet puna dhe organizimi i muzeut, emri, selia, objektet e punës dhe çështjet tjera që janë me rëndësi për punën e muzeut, të përcaktuara me këtë ligj ose ligj tjetër.

(3) Këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit jep pëlqim për statutin.

Udhëheqja me muzetë lokalë

Neni 11

(1) Me muzeun lokal udhëheq drejtori.

(2) Prefekti e zgjedh dhe shkarkon drejtorin e muzeut.

(3) Drejtori i muzeut zgjedhet me konkurs publik, i cili shpallet në mjetet e informimit publik, më së voni tre muaj para kalimit të mandatit të drejtorit paraprak. Konkursin e shpallë prefekti.

(4) Kandidatët ia paraqesin dokumentet e nevojshme në pajtim me konkursin këshillit drejtues të muzeut. Kandidatët për drejtor detyrimisht paraqesin propozimprogram për zhvillimin e muzeut.

(5) Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni treanëtarësh i formuar nga këshilli drejtues i muzeut. Komisioni është i obliguar që në afat prej pesë ditësh nga përfundimi i konkursit, t'i shqyrtojë dokumentet e paraqitura.

(6) Komisioni i paraqet propozim prefektit.

(7) Prefekti në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së propozimit bën zgjedhjen e drejtorit.

(8) Drejtori zgjedhet me mandat prej 4 vjetësh.

(9) Kandidatët që nuk janë zgjedhur, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të vendimit të prefektit, kanë të drejtë për ankesë lidhur me zbatimin e procedurës për zgjedhjen e drejtorit në Komisionin e shkallës së dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë kompetent për zgjidhjen e çështjeve nga lëmi i marrëdhënieve të punës.

(10) Kundër vendimit të Komisionit nga paragrafi 9 i këtij neni kandidati ka të drejtë për padi në Gjykatën themelore kompetente.

(11) Kushtet e veçanta dhe procedura për zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorit rregullohen me statutin e muzeut.

(12) Në rastin kur nuk është zgjedhur drejtori i muzeut ose para kohe i ka kaluar mandati, prefekti menjëherë emëron ushtrues detyre drejtor, pa konkurs, nga radhët e të punësuarve. Ushtruesi i detyrës drejtor emërohet për kohën deri në zgjedhjen e drejtorit të muzeut, kurse më gjatë për gjashtë muaj.

(13) Ushtruesi i detyrës drejtor i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet e drejtorit të muzeut.

Administrimi me muzeun lokal

Neni 12

(1) Organ i administrimit të muzeut lokal është këshilli drejtues.

(2) Këshillin drejtues e përbëjnë pesë përfaqësues të cilët i emëron Këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, prej të cilëve tre janë përfaqësues nga radhët e individëve të dalluar nga lëmi i kulturës dhe dy përfaqësues nga radhët e të punësuarve në muze, persona profesionalë dhe kompetentë.

(3) Këshilli drejtues i muzeut miraton statutin e muzeut, përcakton politikën dhe parimet për zhvillimin e muzeut, propozon programin vjetor për punën e muzeut, planin financiar dhe llogarinë vjetore të muzeut dhe bën punë tjera të përcaktuara me aktin për themelim dhe statutin.

(4) Çështjet tjera të lidhura me punën e këshillit drejtues rregullohen me statutin e muzeut.

Financimi i muzeve lokalë

Neni 13

(1) Mjetet për financimin e veprimtarisë së muzeve lokalë sigurohen në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me ligj.

(2) Muzeu u paraqet për miratim Këshillit të komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit programin vjetor për punë, raportin për punë dhe planin financiar.

Themelimi i muzeve privatë

Neni 14

(1) Muze privat themelon personi juridik dhe fizik i vendit dhe i huaj, nën kushtet e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji dhe me Ligjin për kulturë dhe Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

(2) Fondin muzeor të muzeut privat mund ta përbëjë vetëm materiali i muzeut.

(3) Fondi muzeor i muzeut privat merr statusin e të mirës së mbrojtur nëse në procedurën e përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore për të njëjtin nxirret akt përkatës për mbrojtje.

(4) Në rastet e përcaktuara në paragrafin (3) të këtij neni për punën e muzeve privatë, zbatohen dispozitat të cilat vlejné për pronarët e të mirave të mbrojtura, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

IV. PUNA E MUZEVE

Puna e muzeve

Neni 15

(1) Muzetë në mënyrë të veçantë i bëjnë punët vijuese:

1) hulumtojnë, grumbullojnë, rregullojnë, përpunojnë dhe studiojnë profesionalisht dhe shkencorisht, mbrojnë, botojnë dhe prezantojnë materiale dhe lëndë muzeore;

2) nëpërmjet vendosjes së përhershëm të ekspozitave, ekspozitave të kohëpaskohshme dhe lëvizëse, ligjëratave, seminarëve, punëtorive dhe praktikumeve, shfaqjes së filmave dhe formave tjera të veprimit, i njoftojnë qytetarët me lëndët muzeore dhe veprojnë në mënyrë edukative për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrës së Republikës së Maqedonisë;

3) sigurojnë kushte për shfrytëzimin dhe për studimin shkencor profesional të lëndëve muzeore;

4) japin iniciativa për nxjerrjen e dispozitave dhe masave për përparimin e veprimtarisë muzeore dhe për përkryerjen e kuadrove muzeore;

5) botojnë publikime shkencore dhe profesionale, katalogje, udhërfyese dhe material tjetër propagandues;

6) mbajnë libër hyrjeje, libër inventari, libër daljeje, kratotekë të lëndëve muzeore, katalog të lëndëve muzeore dhe lloj tjetër të evidencës dhe dokumentacionit muzeor;

7) kryejnë punë tjera në lëmin veprimtarisë muzeore, në pajtim me ligjin.

(2) Punët nga paragrafi (1) i këtij neni sipas llojit të materialit muzeor dhe llojit të lëndëve muzeore, muzetë i kryejnë në rajonin në të cilin janë themeluar.

Muzetë amë

Neni 16

(1) Për shkak të përparimit dhe koordinimit të punës së muzeve në territorin e Republikës së Maqedonisë, me këtë ligj dhe me ligj tjetër rregullohen muzetë amë.

(2) Për muze amë sipas llojit të lëndëve muzeore verifikohen Institucioni nacional “Muzeu i Maqedonisë” - Shkup dhe Institucioni nacional “Muzeu natyror-shkencor” - Shkup.

Puna e muzeve amë

Neni 17

Muzetë amë sipas llojit të lëndëve muzeore, përpos punëve nga neni 15 i këtij ligji, i kryejnë edhe punët vijuese:

1) organizojnë bashkëpunim ndërmjet muzeve në Republikën e Maqedonisë;

2) koordinojnë punën e muzeve për shkak të përparimit të veprimtarisë së tyre;

3) u ofrojnë ndihmë të nevojshme profesionale;

4) i japin mendim ministrit për plotësimin e kushteve nga neni 7 dhe 9 i këtij ligji;

5) marrin pjesë në procedurën për regjistrimi e trashëgimisë së tundshme që e mban Republika e Maqedonisë;

6) përcakton ekzistimin e kushteve për mbrojtjen e veçantë të eksponateve të huaja muzeore kur jepet siguri për ekspozimin e objekteve;

7) kryejnë punë tjera me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

V. VEPRIMTARIA E MUZEVE

Furnizimi i materialit muzeor dhe lëndëve muzeore

Neni 18

Muzetë, material muzeor dhe lëndë muzeore furnizojnë nëpërmjet hulumtimeve, rëmiheve, blerjes, dhuratave, legatëve, testamenteve, shkëmbimit dhe mënyrës tjetër, si dhe nëpërmjet lënies dhe marrjes nga persona tjerë juridikë dhe fizikë në pajtim me këtë ligj.

Ruajtja e lëndëve muzeore

Neni 19

Për shkak të mbajtjes dhe shfrytëzimit të përhershëm të lëndëve muzeore, muzetë janë të obligur t'i ruajnë në kushte dhe me zbatimin e mjeteve teknike bashkëkohore, të cilat sigurojnë kompleksitetin dhe mbrojtjen e tyre efikase.

Evidenca dhe dokumentacioni muzeor

Neni 20

- (1) Muzetë janë të obliguar të mbajnë evidencën muzeore dhe dokumentacionin muzeor.
- (2) Evidenca muzeore përmban librin e hyrjes, librin e inventarit, librin e daljes, librin e ekspozitave, kartotekën e lëndëve muzeore, katalogun e lëndëve muzeore, bazën elektronike të dhuratave dhe llojin tjetër të evidencës.
- (3) Muzetë lokalë në njësitë e vetadministrimit lokal në rajonin e të cilave janë themeluar dhe në të cilat përveç gjuhës maqedonishte dhe alfabetit të saj cirilik, është zyrtare gjuha dhe alfabeti të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, librin e hyrjes dhe katalogun e lëndëve muzeore i mbajnë në gjuhën maqedonishte dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin të cilën e flasin së paku 20% nga qytetarët në Republikën e Maqedonisë në rajonin e asaj njësie të vetadministrimit lokal.
- (4) Dokumentacioni muzeor përmban të dhëna për lëndët muzeore, të cilat janë të nevojshme për përpunimin e tyre profesional, identifikimin, mënyrën dhe gjendjen në të cilën janë furnizuar, ndryshimet e bëra, proceset e përpunimit, etj.
- (5) Përpunimi profesional i lëndës muzeore bëhet në afat prej një viti nga dita e regjistrimit të tij në librin e hyrjes deri në ditën e evidentimit të tij në librin e inventarit. Përpunimi profesional i lëndës muzeore nga lëmi i natyrës bëhet në afat prej tri vjetësh nga dita e regjistrimit të tij në librin e hyrjes deri në ditën e evidentimit të tij në librin e inventarit.
- (6) Ministri përshkruan formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së librit të hyrjes, librit të inventarit, librit të daljes, kartotekës dhe llojeve tjera të evidencës muzeore dhe dokumentacionit muzeor nga paragrafi (2) dhe (4) i këtij neni.

Revizioni i lëndëve muzeore

Neni 21

- (1) Muzetë janë të obliguar të bëjnë revizionin e lëndëve muzeore.
- (2) Me revizion përcaktohet gjendja e lëndëve muzeore dhe nevoja për ndërmarrjen e masave përkatëse për mbrojtjen e tyre efikase.
- (3) Revizioni i lëndëve muzeore bëhet së paku në çdo pesë vjet.
- (4) Mënyra se si bëhet revizioni i lëndëve muzeore përcaktohet me statut ose me akt tjetër të përgjithshëm të muzeut.

Çregjistrimi i lëndëve muzeore dhe materialit muzeor nga evidenca

Neni 22

- (1) Lëndët muzeore në muzetë publikë mund të çregjistrohen nga evidenca në librin e inventarit në bazë të aktit për ndërprerjen e mbrojtjes, në mënyrë dhe procedurë të përshkruar me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe ligj tjetër.
- (2) Materiali muzeor i evidentuar në librin e hyrjes për të cilin me komision do të vërtetohet se e ka humbur rëndësinë që të jetë i evidentuar si material muzeor, do të çregjistrohet nga evidenca në librin e hyrjes në pajtim me dispozitat për punën materiale-financiare.
- (3) Komisionin nga paragrafi (2) i këtij neni e formon drejtori i muzeut.

Veprimtaria shkencore-arsimore dhe veprimtaritë tjera të muzeut

Neni 23

- (1) Gjatë kryerjes së veprimtarive të veta kryesore, si dhe veprimtarive të lidhura me to, muzetë kryejnë edhe punë me interes për shkencën dhe arsimin.
- (2) Muzetë përhapin njohuri për vlerën dhe rëndësinë e vlerës kulturore dhe shkencore të lëndëve muzeore dhe zbatojnë aktivitete edukative-arsimore për mbrojtjen e natyrës.

(3) Muzetë përgatisin dhe realizojnë programe arsimore interaktive, të orientuar me përparesi ndaj fëmijëve, nxënësve dhe studentëve.

(4) Muzetë janë të obliguar t'u mundësojnë vizitorëve prezentim të qartë të lëndëve të ekspozuara muzeore, nëpërmjet vendosjes së mbishkrimeve, shenjave, botimit të udhërfyesve etj.

(5) Muzetë mund të kryejnë edhe veprimtari tjera që janë në funksion të vizitueshmërisë më të mirë, prezentimit komercial dhe marketingut të muzeut, siç është hapja e kafiterive, shitja e kopjeve, materiali informativ, e ngjashëm nën kushte të përcaktura me ligj.

Prezentimi i lëndëve muzeore

Neni 24

(1) Muzetë bëjnë prezentimin e lëndëve muzeore nëpërmjet organizimit të ekspozitave të përhershme dhe të përkohshme, si dhe nëpërmjet informatave plotësuese për veprimtarinë e tyre.

(2) Prezentimet organizohen në bazë të parimeve shkencore dhe mënyrës, e cila mundëson themelimin e vlerës kulturore dhe shkencore të lëndëve të ekspozuara muzeore.

(3) Prezentimi i lëndëve muzeore bëhet nën kushte dhe mënyrë me të cilën garantohet siguria e plotë e lëndëve muzeore.

Koha e punës së muzeve

Neni 25

(1) Koha e punës së muzeve duhet të organizohet në mënyrë që u mundëson vizitë të gjitha grupeve qëllimore të vizitorëve.

(2) Muzetë janë të obliguar t'i shpallin publikisht ditët dhe orët për vizitë. Në ditë për vizita mund të përcaktohen edhe ditët për pushim dhe festa shtetërore, në pajtim me dispozitat për marrëdhënie pune.

(3) Muzetë janë të obliguar që së paku njëherë në muaj të sigurojnë hyrje pa pagesë në muze.

(4) Fëmijët, nxënësit dhe studentë, si dhe personat me nevoja të posaçme paguajnë çmime me zbritje të biletave ose lirohen nga pagimi i biletës.

(5) Çështjet nga paragrafet (2), (3) dhe (4) të këtij neni, rregullohen më afër me statutin e muzeut.

Përpunimi i kopjeve të lëndëve muzeore

Neni 26

Lëndët muzeore mund të riprodhohen në kopje muzeore dhe në kopje komerciale, në pajtim me këtë ligj.

Kopje muzeore

Neni 27

(1) Kopje muzeore është lënda e sapokrijuar, e cila e rikonstruon vizuelisht në mënyrë maksimale saktë me karakteristikat esenciale lëndën muzeore.

(2) Kopja muzeore në mënyrë të obligueshme shenjëzohet me shenjën e cila tregon se është fjala për kopje.

(3) Kopja muzeore e lëndës muzeore përpunohet për nevojat e prezentimit të lëndës muzeore në rastet:

1) kur kjo është e nevojshme për shkaqe të sigurisë;

2) kur nuk ekzistojnë kushte për ruajtjen e saj në instalimin e ekspozitës muzeore;

(3) Kur lënda i është dhënë muzeut tjetër; dhe

(4) Kur ekziston nevoja e domosdoshme për ekspozimin e saj në muze tjetër.

(4) Për një lëndë muzeore nuk mund të përpunohen më shumë se pesë kopje muzeore. Për çdo kopje muzeore, muzeu jep vërtetim.

- (5) Kopja muzeore nuk guxon të shfrytëzohet për qëllime komerciale.
(6) Në muze mbahen regjistra të kopjeve muzeore.
(7) Përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të kopjeve muzeore nga paragrafi (6) i këtij neni dhe formularin e vërtetimit nga paragrafi (4) i këtij neni i përshkruan ministri.

Përpunimi i kopjeve komerciale dhe riprodhimi i lëndëve muzeore

Neni 28

(1) Kopje komerciale është lënda e sapokrijuar, e cila vizuelisht e rikonstruon lëndën muzeore, kurse përpunohet për shkak të destinimit të tyre arsimor, prezentues dhe tregtar, në proporcion që dallon nga lënda muzeore.

(2) Lëndët dhe dokumentacioni muzeor mund të riprodhohen me fotografi, me kompjuter dhe në mënyrë tjetër.

(3) Kopjet nga paragrafi (1) i këtij neni dhe riprodhimi nga paragrafi (2) i këtij neni mund të përpunohen nga persona fizikë dhe juridikë, me marrjen e pëlqimit paraprak nga muzeu, në mënyrë dhe kushte të përcaktuara nga muzeu.

(4) Kopjet nga paragrafi (1) i këtij neni dhe riprodhimi nga paragrafi (2) i këtij neni shenjëzohen në mënyrë përkatëse me emrin e lëndës muzeore, prej cilës periudhë daton, lokaliteti, emri i autorit dhe emri i muzeut, lëndë e të cilit është.

(5) Shenjëzimin e bën muzeu për lëndën e të cilit është përpunuar kopja, lënda e të cilit është riprodhuar.

(6) Mënyrën me të cilën bëhet shenjëzimi e përcakton ministri me akt nga neni 27 paragrafi (7) i këtij ligji.

Përdorimi i lëndës muzeore për qëllime komerciale

Neni 29

Prodhimi i mallrave, etiketave dhe zgjidhjeve të dizajnit, në të cilat përmbahen fotografi ose tregues grafikë të lëndëve muzeore, bëhet në pajtim me Ligjin për trashëgiminë kulturore.

Sigurimi i lëndëve muzeore

Neni 30

Lëndët muzeore të muzeve publikë, dokumentacioni për to dhe hapësira në të cilën është vendosur muzeu, në mënyrë të obligueshme sigurohen te shoqata siguruese, me mjete të cilat i siguron themeluesi.

VI. SIGURIMI I EKSPONATEVE DHE EKSPOZITAVE NË BOTËN E JASHTME Sigurimi

Neni 31

Sigurimi në kuptimin e këtij ligji është garancia se Republika e Maqedonisë për kompensim nga dëmi i eksponeve dhe ekspozitave, të bëra me marrëveshje përkatësisht të organizuara në territorin e Republikës së Maqedonisë, nga ana e muzeve publikë.

Kushtet për dhënien e sigurimit

Neni 32

(1) Sigurim në kuptim të nenit 31 të këtij ligji nuk mund të jepet për:

1) ekspozate përkatësisht ekspozita nga bota që kanë vlerë të posaçme shkencore, kulturore, shkencore-natyrore, artistike dhe historike, nëse prezantimi i tyre është kushtëzuar me sigurimin paraprak të sigurimit.

2) eksponate përkatësisht ekspozita për të cilat shpenzimet e sigurimit të shoqata siguruese janë ekskluzivisht të larta për shkak të vlerës së deklaruar të eksponateve, kurse pronari pajtohet të pranojë një mënyrë të këtillë sigurimi.

(2) Sigurim nuk mund të jepet për eksponatet dhe ekspozitat e ndërmarra përkatësisht të organizura për qëllime komerciale.

Vendimi për dhënien e sigurimit

Neni 33

(1) Vendimin për sigurimin në kuptim të nenit 31 të këtij ligji e merr Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozimin e Ministrisë.

(2) Vendimi nga paragrafi (1) i këtij neni mund të merret nëse muzeu publik–organizator i ekspozitës siguron kushte të veçanta për mbrojtjen e eksponateve, siç janë veçanërisht:

1) mbrojtja e pandërprerë fizike e eksponateve nga momenti i marrjes deri në momentin e dorëzimit të tyre;

2) mbajtja e kushteve klimatike dhe kushteve tjera sipas llojit të eksponatit;

3) sigurimi i objekteve dhe hapësirave nga të gjitha llojet e rreziqeve që mund ta rrezikojnë sigurinë e eksponateve.

(3) Sigurimin e kushteve nga paragrafi (2) i këtij neni e përcakton muzeu amë kompetent.

VII. KËSHILLI NACIONAL PËR MUZETË

Këshilli nacional për muzetë

Neni 34

(1) Për shkak të analizës së gjendjes, përcaktimit të masave për përparimin dhe zhvillimin afatgjatë në realizimin e veprimtarisë muzeore, themelohet Këshill nacional për muzetë si trup këshilldhënës dhe profesional i ministrit (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

(2) Këshilli përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë, të cilët i emëron dhe shkarkon ministri.

(3) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit emërohen nga radhët e individëve të dalluar nga lëmi i muzeologjisë, përfaqësuesve nga institucionet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrës, institucioneve shkencore dhe arsimore dhe përfaqësuesve të qytetarëve nga ky lëm.

(4) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit emërohen për një periudhë prej katër vjetësh dhe serish mund të emërohen.

Kompetenca e Këshillit

Neni 35

Këshilli:

1) i shqyrton çështjet e ndryshme lidhur me realizimin e veprimtarisë muzeore;

2) i përcjell dhe analizon të arriturat dhe gjendjen në veprimtarinë muzeore;

3) jep mendim dhe propozime për strategjinë e zhvillimit dhe përparimit të mëtejshëm të veprimtarisë muzeore;

4) diskuton për çështjet kontestuese lidhur me veprimtarinë muzeore dhe jep mendim për zgjidhjen e tyre;

5) studion dhe jep mendim për organizimin e rrjetit muzeor në Republikën e Maqedonisë;

6) miraton rregullore për punën e vet; dhe

7) kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj.

Punët administrative të Këshillit

Neni 36

Punët administrative dhe teknike të Këshillit i kryejnë të punësuarit në Ministri.

VIII. TITUJT SHKENCORË

Kryerja e punëve profesionale në muze

Neni 37

Në muze punët profesionale i kryejnë punëtorët me tituj profesionalë zgjedhorë, me tituj profesionalë jozgjedhorë dhe punëtorë me tituj tjerë profesionalë dhe zgjedhorë.

Titujt profesionalë zgjedhorë

Neni 38

Punët profesionale në muze i kryejnë punëtorët me tituj zgjedhorë:

- 1) kustos i lartë dhe
- 2) kustos këshilltar.

Kushte të veçanta për zgjedhje në kustos i lartë dhe kustos këshilltar

Neni 39

(1) Në titullin kustos i lartë mund të zgjedhet personi i cili ka:

- 1) kryer studimet e magjistraturës nga lëmi përkatës dhe tri vjet punë si kustos ose së paku dhjetë vjet punë si kustor; dhe
- 2) projekte të botuara dhe të realizuara profesionale me rëndësi për përparimin e veprimtarisë muzeore; dhe
- 3) aftësi për organizimin e pavarur të punës profesionale.

(2) Personi i zgjedhur në titullin nga paragrafi (1) i këtij neni rizgjedhet pas kalimit të çdo të pestit vit.

Neni 40

(1) Në titullin kustos-këshilltar mund të zgjedhet personi i cili ka:

- 1) doktoranturë shkencash nga lëmi përkatës dhe tri vjet punë si kustos i lartë ose së paku dhjetë vjet punë si kustor i lartë; dhe
- 2) projekte të botuara profesionale të dalluara dhe të realizuara me rëndësi të posaçme për përparimin e veprimtarisë muzeore nga lëmi më i ngushtë për të cilin zgjedhet; dhe
- 3) Shkallë të lartë pavarësie në organizimin e punës profesionale.

(2) Personi i zgjedhur në titullin nga paragrafi (1) i këtij neni rizgjedhet pas përfundimit të çdo të pestit vit.

(3) Me përjashtim, personi i zgjedhur në titull nga paragrafi (1) i këtij neni, pas rizgjedhjes së parë nuk rizgjedhet.

Kompetenca dhe procedura për zgjedhjen në titull profesional zgjedhor

Neni 41

(1) Zgjedhjen dhe rizgjedhjen në tituj profesionalë zgjedhorë nga neni 39 dhe 40 të këtij ligji e bën ministri, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në bazë të vlerësimit të komisionit për recenzim.

(2) Procedura për zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titull profesional zhvillohet me kërkesën e punëtorit të interesuar profesional. Procedura për rizgjedhje mund të zhvillohet edhe me iniciativën e drejtorit të muzeut ose nga ana e organit të administrimit të muzeut, më së voni në afat prej tre muajsh para kalimit të afatit për rizgjedhje.

(3) Komisioni për recenzim nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet prej së paku tre anëtarësh, të zgjedhur nga radhët e personave të cilët kanë së paku titull të njëjtë për të cilin bëhet zgjedhja, përkatësisht rizgjedhja ose kanë titull përkatës shkencor. Mëse gjysmëm e anëtarëve të komisionit e përbëjnë personat e lëmit të njëjtë profesional në të cilin zgjedhet kandidati.

(4) Komisioni për rizgjedhje paraqet raport me shkrim në afat të përcaktuar me akt për formimit e tij.

(5) Raporti nga paragrafi (4) i këtij neni përmban të dhëna biografike për kandidatin, pasqyrën dhe notën e punës së tij profesionale dhe vlerësimin për plotësimin e kushteve për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje.

(6) Procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titull profesioanl zgjat më së shumti tre muaj.

Titujt profesionalë jozgjedhorë

Neni 42

Punët profesionale në muze i kryejnë punëtorët me tituj profesionalë jozgjedhorë, të cilët kanë arsimim të mesëm përkatës për titullin preparator, arsimim përkatës të lartë për titullin preparator i lartë i pavarur dhe arsimimin përkatës sipëror për titullin kustos, në pajtim me aktet e përgjithshme të muzeut.

Kryerja e punëve tjera profesionale në muze

Neni 43

Punë të caktuara profesioanle në muze mund të kryejnë edhe punëtorët që kanë tituj profesionalë, si dhe tituj profesionalë në lëmin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, lëndës arkivore dhe veprimtarisë bibliotekiste dhe punëtorë tjerë, në pajtim me aktin e përgjithshëm të muzeut.

IX. MBIKËQYRJA

Kryerja e mbikëqyrjes

Neni 44

(1) Mbikëqyrjen e këtij ligji e bën Ministria.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së punës të organeve të komunës, Ministria i bën punët vijuese:

1) përcjell ligjshërinë e punës së organeve të komunës dhe ndërmerr masa dhe aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizmin e kompetencave të komunës në pajtim me këtë ligj;

2) vlerëson se a sigurojnë organet e komunës që kompetencat e komunës të zbatohen në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara me këtë ligj;

3) jep rekomandime për zbatimin konsekuent të kompetencave të komunës në kuadrin e kompetencave të përcaktuar me këtë ligj, me kërkesën e organeve të komunës;

4) përcjell ligjshmërinë e vendimeve të cilat i merr prefekti në zgjidhjen e të drejtave të caktuara gjatë zgjedhjes së drejtorit të muzeut; dhe

5) i paralajmëron me kohë organet e komunës për gjendjen e konstatuar në punën e tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(3) Mbikëqyrjen inspektuese të zbatimit të këtij ligji e bën Ministria nëpërmjet inspektorëve për kulturë në pajtim me Ligjin për kulturë dhe Drejtorinë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, përkatësisht organit të caktuar me dispozitat për mbrojtjen e natyrës.

X. DISPOZITA NDËSHKIMORE

Ndëshkimet

Neni 45

(1) Me dënim me para mbi 100.000 deri 200.000 denarë do të ndëshkohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

1) kryen veprimtari muzeore pa vendim se i plotëson kushtet për fillimin me punë të muzeut (neni 7);

2) nuk mban libër hyrjeje, libër inventari, libër daljeje dhe lloje tjera të evidencës (neni 20 paragrafi (1));

3) në afatin e caktuar nuk e përpunon profesionalisht lëndën muzeore (neni 20 paragrafi (3));

4) nuk bën revizionin e lëndëve muzeore (neni 21);

5) Publikisht nuk i vendos ditët dhe orët për vizitë dhe nuk përcakton çmime me zbritje për lloje të caktuara të vizitorëve (neni 25 paragrafi (2), (3) dhe (4));

6) nuk i shenjëzon kopjet muzeore me shenjë se është fjala për kopje (neni 27 paragrafi (2));

7) për një lëndë muzeore përpunon më shumë se 5 kopje (neni 27 paragrafi (4));

8) përdor kopje muzeore për qëllime komerciale (neni 27 paragrafi (5));

9) nuk mban regjistër të kopjeve muzeore (neni 27 paragrafi (6)) dhe

10) përpunon kopje me qëllim komercial dhe riprodhon lëndë muzeore pa pëlqim nga muzeu (neni 28).

(2) Me dënim me para prej 10.000 deri 30.000 denarë do të ndëshkohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personi përgjegjës në personin juridik.

(3) Me dënim me para prej 10.000 deri 50.000 denarë për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni do të ndëshkohet edhe tregtari-individ.

(4) Me dënim me para prej 10.000 deri 30.000 denarë për kundërvajtje nga paragrafi (1) pika 10 të këtij neni do të ndëshkohet edhe personi fizik.

(5) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) pika 10 të këtij neni, personit juridik dhe fizik mund t'i shqiptohet masa e sigurisë marrje e lëndëve të cilat janë fituar me kryerjen e kundërvajtjes.

XI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Vlerësimi i punës së muzeve ekzistues

Neni 46

Ministria, në bashkëpunim me muzeun kompetent amë në afat prej tri vjetësh nga dita e zbatimit të ligjit, do të bëjë vlerësimin e kushteve për fillimin me punë të muzeve të cilët janë themeluar para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, me ç'rast në mënyrë përkatëse zbatohen nenet 8 dhe 9 nga ky ligj.

Themelimi i Këshillit

Neni 47

Këshilli do të themelohet në afat prej 30 ditësh nga dita e zbatimit të këtij ligji.

Akte nënligjore

Neni 48

Dispozitat, nxjerrja e të cilave është paraparë me këtë ligj, do të nxirren më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të dispozitës nga neni 20 paragrafi (6) i këtij ligji, vazhdon të zbatohet Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës dhe dokumentacionit të lëndës muzeore ("Gazeta zyrtare e RSM" nr. 32/80).

Tutuj profesionalë

Neni 49

Personave, të cilët deri në ditën e zbatimit të këtij ligji kanë marrë titullin kustos i lartë dhe kustos-këshilltar, në pajtim me Ligjin për veprimtari muzeore ("Gazeta zyrtare e RSM" nr. 25/79, 51/88 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonise" nr. 12/93, titujt e fituar u njihen.

Ndërprerja e ligjit ekzistues

Neni 50

Me ditën e zbatimit të këtij ligji ndërpritet të vlejë Ligji për veprimtarinë muzeore (“Gazeta zyrtare e RSM” nr. 25/79, 51/88 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 12/93)

Hyrja në fuqi e Ligjit dhe fillimi i zbatimit të Ligjit

Neni 51

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë, kurse do të zbatohet prej konstituimit të këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe zgjedhjes së prefektëve të komunave dhe prefektit të Qytetit të Shkupit pas zbatimit të zgjedhjeve të para të ardhshme lokale në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 46/96, 12/2003, 35/2004, 52/2004 dhe 60/2004).